

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA			
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA			
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH			
Njësia Org Org./Jednica Org Unit	02	Nr. Prot: Broj Prot Prot No.	05-751
Nr. i faqëve Sr. stranica No. pages	-7-	Data: Datum: Date:	05/02/2026
Prishtinë / a			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
*Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva*

## PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE / PSO

EMRI I PSO: MARRJA, TRANSPORTI DHE PËRPUNIMI I MOSTRES SE SPUTUMIT /  
LAVAZH LUKTHI ME METODËN BIOFIRE-PNEUMONIAE PANEL  
(ITR13/V1.0)

PËRMBAJTJA: DOKUMENTI PËRFSHIN HAPAT KRYESORË TË MARRJES SË  
MOSTRAVE, TRANSPORTIT DHE PËRPUNIMI I SPUTUMIT/LAVAZH  
LUKTHI ME METODËN BIOFIRE-PNEUMONIAE PANEL, DUKE  
SIGURUAR QË TESTIMI TË KRYHET NË MËNYRË TË SAKTË DHE TË  
STANDARDIZUAR PËR IDENTIFIKIMIN E PATOGJENEVE NË  
SPUTUM/LAVAZH LUKTHI.

VERSIONI:1.0  
DATA E APROVIMIT: 03/02/2026  
AUTOR: MSh/IKSHPK  
NR. I HAPAVE: VI  
NR. I NËNHAPAVE:34

APROVUAR: Jahë Gecaj  
U.D. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë



MINISTRIA E SHËNDETËSISË

MARRJA, TRANSPORTI DHE PËRPUNIMI I MOSTRES SE SPUTUMIT/  
LAVAZH LUKTHI ME METODËN BIOFIRE-PNEUMONIAE PANEL (ITR13/V1.0)

QËLLIMI	QËLLIMI I KËSAJ PSO ËSHTË TË SIGUROJË NJË QASJE TË STANDARDIZUAR PËR MARRJEN E MOSTRËS, TRANSPORTIN DHE PËRPUNIMIN E SPUTUMIT/LAVAZH LUKTHI ME METODËN BIOFIRE-RESPIRATORY PANEL. PROCEDURA E PËRSHKRUAR DUHET TË ZBATOHET NGA I GJITHË PERSONELI LABORATORIK .
NDËRLIDHJA ME AKTET	<ul style="list-style-type: none"> <li>• LIGJI NR. 08/L-200 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE;</li> <li>• PLANI STRATEGJIK KOMBËTAR PËR LABORATORE 2024-2030;</li> <li>• DORACAKU PËR MENAXHIMIN E CILËSISË NË LABORATORË;</li> <li>• UDHËZUES PËR PËRDORIM PËR PANELIN BIOFIRE® PNEUMONIAE PANEL 2.1;</li> </ul>
LISTA E SHKURTESAVE	<ul style="list-style-type: none"> <li>• PSO - PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE</li> <li>• PPM - PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE</li> <li>• ITR- INFEKSIONET E TRAKTIT RESPIRATOR</li> <li>• BIOFIRE- EMËR TREGTAR I PLATFORMËS DIAGNOSTIKE TË ZHVILLUAR NGA BIOFIRE DIAGNOSTICS BIOMÉRIEUX</li> </ul>

**PROCEDURA**

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Zbatimi i masave për menaxhim të mostrave	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mostra e sputumit merret nga pacienti dhe dërgohet ne Institucionin përkatës në zyrën e pranimit;</li> <li>2. Mostra transportohet nga laboranti në zyrën e pranimit deri në laboratorin për infeksione të traktit respirator;</li> <li>3. Laboranti kryen pranimin, përfshirë inspektimin e mostrës, ndarjen, përpunimin dhe ruajtjen e saj sipas kritereve të pranimit dhe refuzimit të mostrave për testim mikrobiologjik në Doracakun e Cilësisë.</li> </ol>
[II]	Pajisjet dhe reagjentët që janë të nevojshme për testim:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sigurohu që të gjitha pajisjet mëposhtme janë të disponueshme dhe funksionalë para fillimit të testimit:               <ol style="list-style-type: none"> <li>a. BIOFIRE® System/Platforma automatike Film Array;</li> <li>b. Printer;</li> <li>c. Pipetë automatike + maja sterile;</li> <li>d. Kabineti i biosigurisë (BSC);</li> <li>e. Enë për mbetje biohazard;</li> </ol> </li> <li>2. Sigurohu që të gjithë reagjentët e mëposhtëm të jenë të disponueshëm dhe funksionalë para fillimit të testimit:               <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Strisho me medium transportues;</li> <li>b. Dorëza Nitrile një përdorimëshe S,M, L;</li> <li>c. Qese Biohazard dhe laps-ngjyrë e përhershme; majë e dyfishtë;</li> <li>d. Pajisjet Personale Mbrojtëse (PPM);</li> <li>e. Reagjentët specifik te pakeluar në qese, janë për një përdorim;</li> <li>f. Pako akulli, çantë transporti.</li> </ol> </li> </ol>
[III]	Veprimet laboratorike të marrjes dhe transportit të mostrës	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Marrja e mostrave për diagnozën e infeksioneve të Traktit të poshtëm respirator është Sputumi/Lavazh lukthi;</li> <li>2. Vendos pajisjet mbrojtëse personale (PPM);</li> <li>3. Mostra e sputumit merret nga vet pacienti duke e këshilluar paraprakisht të pastroj gojën me ujë, te largon saliven duke ekspektoruar, kollitet thellë dhe përkulet duke e vendosur sekretin/kelbazën në enë sterile (jo pështymë);</li> </ol>

		<ol style="list-style-type: none"> <li>4. Mostra e Lavazhës së lukthit rekomandohet që për një periudhë prej 4–6 orësh para marrjes së mostrës, të mos konsumohet ushqim apo lëngje, me qëllim të reduktimit të rrezikut për të vjella;</li> <li>5. Vendoset një tub nazogastrik (përmes hundës në lukth), injeksionohen 20–50 ml solucion steril (zakonisht kripë fiziologjike), pas injektimit, lëngu tërhiqet sërish përmes tubit;</li> <li>6. Mbyllet ena sterile me kapak ose me shiringë dhe etiketohet me emrin dhe mbiemrin e pacientit;</li> <li>7. Mostra e Sputumit/Lavazhës së lukthit dërgohet sa me shpejtë që është e mundur në laborator.</li> </ol>
[IV]	Veprimet e laboratorike të përpunimit të mostrës	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Procedura e përpunimit të mostrës zbatohet nga personeli i trajnuar i laboratorit mikrobiologjik, që punon me mostra respiratore të pacientëve;</li> <li>2. Laboranti regjistron mostrën me informacionin e numrit identifikues të mostrës (numri i regjistrimit);</li> <li>3. Vendos pajisjet mbrojtëse personale (PPM);</li> <li>4. Lëre mostrën të arrijë temperaturën e dhomës nëse ka ardhur nga frigoriferi;</li> <li>5. Nxirr një komplet testi i cili ndodhet në paketimin e Pneumoniae Panel;</li> <li>6. Tund butësisht tubin e transportit të mostrës për homogjenizim;</li> <li>7. Merr 200 µL nga mostra me pipetë sterile dhe shtoje në Sample Buffer Vial;</li> <li>8. Aktivizo aparatin Biofire;</li> <li>9. Regjistro mostrën në aparat duke skenuar kodin e testit;</li> <li>10. Vendose testin në portën e cila sinjalizohet me drite;</li> <li>11. Kliko startimin e përpunimit të mostrës START;</li> <li>12. Ky proces zgjat rreth 1 orë e 15 minuta për testim individual;</li> <li>13. Analizatori jep rezultatin automatikisht në ekran.</li> </ol>
[V]	Veprimet e laboratorike të leximit të rezultatit	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Testi zakonisht është multiplex, pra detekton materialin gjenetik ADN-ja ose ARN-ja disa patogjenë në të njëjtën kohë;</li> <li>2. Përdoret PCR (Polymerase Chain Reaction) për amplifikimin e ADN-së/ARN-së specifike të viruseve dhe baktereve;</li> <li>3. Verifiko që nuk ka pasur mesazhe gabimi;</li> </ol>

		<p>4. Interpretimi i rezultatit është POZITIV ose NEGATIV;</p> <p>a. <b>Pozitiv:</b> Gjetja e një apo më shumë mikroorganizmave specifike tregon infeksion aktiv ose prani të tyre në mostër;</p> <p>b. <b>Negativ:</b> Nuk është detektuar asnjë patogjen nga paneli i testuar.</p> <p>5. Printo rezultatin dhe vendosi vlerat ne sistemin MedLis;</p> <p>6. Largo testin nga porta e aparatit.</p>
[VI]	Veprimet e laboratorike të raportimit të rezultatit	<p>1. Laboranti vendos të dhënat e regjistruara në fletë përcjellëse nga ana e mikrobiologut në sistemin informativ të laboratorit;</p> <p>2. Laboranti vendos të dhënat në librin e protokollit të laboratorit, respektivisht në data bazat përkatëse të laboratorit;</p> <p>3. Mikrobiologu verifikon rezultatet mbi saktësinë e analizave të raportuara nga laboranti, të dhënat për patogjenët e identifikuar të cilët janë specifikuar në <b>shtojcën 1 të Tabela 1.</b></p>

Shtojca 1.

Tabela 1. Emrat e patogjeneve të cilet detektohen ne Pneumoniae Panel.

Nr.	<b>VIRUSI</b>
1.	Adenovirus
2.	Human Rhinovirus/Enterovirus
3.	Parainfluenza Virus
4.	Coronavirus
5.	Influenza A
6.	Respiratory Syncytial Virus
7.	Human Metapneumovirus
8.	Influenzae B
	<b>BAKTERIE</b>
9.	Acinetobacter calcoaceticus-baumannii complex
10.	Enterobacter cloacae
11.	Escherichia coli
12.	Haemophilus influenzae
13.	Klebsiella aerogenes
14.	Klebsiella oxytoca
15.	Klebsiella pneumoniae
16.	Moraxella catarrhalis
17.	Proteus spp
18.	Pseudomonas aeruginosa
19.	Serratia marcescens
20.	Staphylococcus aureus
21.	Streptococcus agalactiae
22.	Streptococcus pneumonia
23.	Streptococcus pyogenes
24.	Chlamydia pneumoniae

25.	Legionella pneumophila
26.	Mycoplasma pneumonia
	<b>SHTAMET REZISTENTE</b>
27.	Antimicrobial Resistance Genes: CTpneuX-M
28.	Antimicrobial Resistance Genes: NDM
29.	Antimicrobial Resistance Genes: mecA/C and MREJ
30.	Antimicrobial Resistance Genes: OXA-48-like
31.	Antimicrobial Resistance Genes: KPC
32.	Antimicrobial Resistance Genes: VIM